



## DEMOKRACIA FAVORIZON DHE PERSHPEJTON ZHVILLIMIN EKONOMIK

*Alban Daci\**

Rënia e “perdes së hekurt” që ndau kontinentin tonë pas Luftës së II-të Botërore krijoi një mundësi unike për vendet e Europës Juglindore që të shkëputen nga e kaluara totalitare për t’iu bashkangjitur vlerave të demokracisë, të drejtave dhe lirive civile për të ndërtuar shtetin e së drejtës dhe institucionet e tij.

Pas viteve '90 këto vende kanë aspiruar tek Europa e Bashkuar, bazuar në rregullat thelbësore të jetes së përbashkët, të kombeve të lira dhe të barabarta. Këto shpresa mund të bëhen konkrete vetëm nëse këto vende ushtrjnë një demokraci politike dhe sociale të cilat janë elementët përbërës të së njëjtës arkitekture.

Demokracia politike dhe demokracia sociale janë elementët kryesorë bashkues për Europën në konceptin institucional, janë dy vlera të pandashme që luajnë një rol të rëndësishëm edhe në modele ekonomike që kanë njohur zhvillime praktike në jetën shoqërore të çdo shteti.

Sistemi ekonomik për vetë kompleksin e tij kërkon vëzhgime dhe vendime koherente. Modelet ekonomike kanë njohur cikle të ndryshme si progres edhe regres, por ndryshimet më të rëndësishme patjetër që i përkasin mesit të parë të shekullit të kaluar.

Në vitet '20 klienti i vetëm i ekonomisë së një vendi ishte vetë shteti, por falë ideve të reja

ekonomike nga Keynes dhe Say të shfaqura kryesisht në vitet '30 kemi një tendencë drejt ekonomisë së hapur të bazuar mbi tregun e lirë që ka përfaqësuar në mënyrë natyrale më shumë iniciativat dhe aksionet e ndërmarra nga individët se sa iniciativat e ndërmarra nga shteti. Por, këto iniciativa nuk do të ishin realizuar në formën konkrete të tyre pa dëshirën dhe vullnetin e shtetit. Pra, shteti ka qënë nxitësi i këtyre ideve që sollën një stad të ri zhvillimi ekonomik.

Rolin e shtetit në zhvillimin ekonomik të një vendi e shohim qartë tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë lindur si një vend ku problemi parësor është lufta kundër “pushtetit”. E gjithë historia e këtij vendi përfaqëson përpjekjen e vazhdueshme për të vendosur pushtetet në mënyrë që të jenë demokratikisht të kontrolluar. Kjo ka qënë beteja e luftuar në të gjitha fushat: ato kostitucionale me federalizmin, ato ekonomike me antitrustin, ato elektorale për një model organik brenda sistemit.

Në disa vende të Europës Juglindore tregu i lirë nuk është më i aftë tu përgjigjet nevojave të zhvillimit pasi këto vende mbarin një zhvillim energjik të korrupsionit që sjell falimentimin e këtij tregu. Këto vende në përgjithësi janë vende me sistem social pak të zhvilluar dhe me një mekanizëm solidariteti dhe mbështetje sociale pa efikasitet.

Korrupsioni në këto vende ka dobësuar shërbimet publike e ka rritur varfërinë sepse ka pakësuar investimet publike. Për nga madhësia korrupsionin mund ta ndajmë në dy grupe:

– korrupsioni i madh në rastin e abuzimit nga funksionarët e lartë të shtetit

– korrupsioni i vogël në rastin e abuzimit nga funksionarët e vegjël të shtetit

Për të luftuar korrupsionin duhet të kemi parasysh dy aspekte të rëndësishme:

1) Ai duhet parë si një e keqe që mund të luftohet me vendime të drejtpërdrejta (reforma penale, agjenci antikorrupsioni, mbrojtja e informatorëve).

2) Nga ana tjetër si një keq-geverisje. Në këtë rast është e rëndësishme njohja e shkaqeve dhe kryerja e një sërë reformash në drejtësi dhe në administratë.

Korrupsioni ka bërë që pasuria të grumbullohet në duart e një pakice gjë që sjell edhe mos transparencë e cila mund të ketë një zgjidhje të vetme: marrdhënie reciproke mes demokracisë dhe zhvillimit ekonomik.

Pikërisht demokracia favorizon dhe pershpejton zhvillimin ekonomik. Me demokraci nënkuptojmë “qeverisje të mirë” të bazuar tek ligjet, institucionet e shëndosha dhe mbi të gjitha të respektuar nga qytetarët.

Modeli ekonomik duhet të jetë prodhimi i një strukturë ku shteti dhe qytetarët janë partnerë me të drejta të barabarta.

*\*Student për marrdhëniet  
ndërkombëtare dhe diplomatike,  
Universiteti i Gjenovës, Itali*

**FTESE PER DISKUTIM RRETH IDESE SE NJE MASTER PLANI PER ARSIMIN E LARTE DHE SHKENCEN NE SHOIPERI**

*Myqerem Tafaj*

Të nderuar miq,  
bashkangjitur po iu dërgoj një ide rreth një master plani për arsimin e lartë dhe shkencën në Shqipëri.

Siç mund të keni dëgjuar Komiteti i Orientimit të Politikave pranë Partisë Demokratike e pranoi propozimin tim për një master plan dhe vetë PD-ja u prononcua e gatshme për këtë program nëse do të fitojë zgjedhjet e ardhëshme.

Materiali që po iu dërgoj është botuar edhe në gazetën TEMA në Tiranë në 3 pjesë.

Mendimet dhe sugjerimet e kolegëve të Alb-Shkencës do jenë shumë të çmuara për mua si autor dhe për komi-

sionin përkatës. Siç do të shihni në material, unë i kam dhënë shumë përparësi politikave "brain gain" (kthimit të trurit).

Të dashur miq, sot pranohet gjerësisht edhe në Shqipëri që studentet dhe shkencëtarët shqiptarë jashtë vendit janë një pasuri e madhe për atdheun.

Rikthimi i një pjese të tyre është një domosdoshmëri për të kryer reforma të thella demokratike në të gjitha fushat. Mentaliteti i ndryshuar, përvoja e fituar në bashkëpunimin me botën dhe përgatitja e lartë profesionale që kanë vajzat dhe djemtë shqiptarë në shkollat dhe institucionet perëndi-

more janë cilësi të rëndësishme që i duhen sot Shqipërisë.

Këtë koncept unë e parashtrova edhe në diskutimin publik në Tiranë dhe gjeta një përkrahje të madhe nga shumë kolegë të universiteteve shqiptare.

Për leximin e materialit dhe shprehjen e mendimeve tuaja iu jam shumë mirënjohës.

Dokumentin e plotë mund ta gjeni në adresën elektronike të listës së diskutimit të Alb-Shkencës:

[http://www.alb-net.com/pipermail/alb-shkenca/attachments/20050406/6c103e01/MastPlan\\_Alshkenca-0001.doc](http://www.alb-net.com/pipermail/alb-shkenca/attachments/20050406/6c103e01/MastPlan_Alshkenca-0001.doc)

Ju përshëndes përzemërsisht  
Myqerem Tafaj  
[tafaj@uni-hohenheim.de](mailto:tafaj@uni-hohenheim.de)

Universiteti Politeknik i Tiranës dhe UNESCO kanë hartuar një projekt për kthimin e pedagogëve dhe studjuesve shqiptarë të larguar në vendet perëndimore.

Projekti ka për qëllim ndalimin e rrjedhjes së trurit, fenomen shumë i përhapur në Shqipëri në këtë dhjetëvjeçarin e fundit.

Rikthimi i pedagogëve mendohet të arrihet përmes pagave të larta dhe përmirësimit të kushteve të punës.

Sipas një botimi të Qendrës Shqiptare të Studimeve për Migracionin, financuar nga IOM (International Organization for Migra-

tion), gjatë 15 viteve të fundit kanë emigruar pothuaj gjysma e profesorëve dhe studiuesve të universiteteve dhe institucioneve kërkimore të vendit. E thënë ndryshe më shumë se 65 për qind e pedagogëve që patën marrë gradën shkencore "Doktor i Shkencave" në universitetet perëndimore gjatë viteve 1980-1990, janë larguar jashtë vendit.

"Përqindja e specialistëve që nuk punojnë në profesionin e tyre varion me 74 për qind në Greqi, 67 për qind

në Itali, 58 për qind në Austri dhe 70 për qind në Shtetet e Bashkuara të Amerikës", thuhet në studimin e lartpërmendur. Ikjet janë ndërë sigurisht dhe në Universitetin e Tiranës, ku katedrat e mësimdhënies "janë pushtuar" nga pedagogë të jashtëm.

Ky fenomen është më i dukshëm në Universitetin Politeknik, në degët e Inxhinierive.

Marrë nga  
[www.balkanweb.com](http://www.balkanweb.com)

## KINETIC DESORPTION AND SORPTION OF U(VI) DURING REACTIVE TRANSPORT IN A CONTAMINATED HANFORD SEDIMENT

Te nderuar kolegë dhe miq të Alb-Shkencës,

po ju dërgoj më poshtë përbledhjen e një artikulli të botuar së fundi në revistën shkencore: *Environment&Science and Technology*, që botohet nga American Chemical Society. Referenca e plotë e artikullit është:

N.P. Qafoku, J.M. Zachara, C. Liu, P.L. Gassman, O.S. Qafoku, and S.C. Smith. 2005. *Kinetic desorption and sorption of U(VI) during reactive transport in a contaminated Hanford sediment*. Environ. Sci. Technol., 39: 3157-3165.

Unë kam kopje në formatin .pdf të këtij artikulli e për të gjithë ata që janë të interesuar mund t'jua dërgoj.

### Abstract

Column experiments were conducted to investigate U(VI) desorption and sorption kinetics in a sand-textured, U(VI) contaminated (22.7  $\mu\text{mol kg}^{-1}$ )

capillary fringe sediment from the U.S. Department of Energy (DOE) Hanford site.

Saturated column experiments were performed under mildly alkaline conditions representative of the Hanford site where uranyl-carbonate and calcium-uranyl-carbonate complexes dominate aqueous speciation. A U(VI) free solution was used to study contaminant U(VI) desorption in columns where different flow rates were applied. Sorbed, contaminant U(VI) was partially labile (11.8%) and extended leaching times and water volumes were required for complete desorption of the labile fraction. Uranium(VI) sorption was studied after the desorption of labile, contaminant U(VI) using different U(VI) concentrations in the leaching solution. Strong kinetic effects were observed for both U(VI) sorption and desorption, with half-life ranging from 8.5 to 48.5 h for sorption, and from

39.3 to 150 h for desorption. Although U(VI) is semi-mobile in mildly alkaline, subsurface environments, we observed substantial U(VI) adsorption, significant retardation during transport, and atypical breakthrough curves with extended tailing. A distributed rate model was applied to describe the effluent data and to allow comparisons between the desorption rate of contaminant U(VI) with the rate of short-term U(VI) sorption. Desorption was the slower process. We speculate that the kinetic behavior results from transport or chemical phenomena within the phyllosilicate dominated fine fraction present in the sediment. Our results suggest that U(VI) release and transport in the vadose zone and aquifer system from which the sediment was obtained are kinetically controlled.

**Niko Qafoku Ph.D.**

**Richland, WA, SHBA**

[http://emslbios.pnl.gov/id/qafoku\\_n](http://emslbios.pnl.gov/id/qafoku_n)

## VEZHGIMI NE BRENDESI TE QELIZES PERMES SONDAVE NANOMETRIKE

Shkencëtarët në Berkeley Lab dhe Lawrence Livermore National Laboratory janë duke përdorur sonda nanometrike për të vëzhguar brendësinë e qelizave. Në këtë mënyrë është e mundshme të ndiqen proceset e ndryshme të jetës si korrigjimi i ADN-së apo veprimin e barnave mjekësore etj.

Sondat janë të ndërtuara nga gjysmëpërçues specialë kristali, të përbërë nga disa mijëra atome të cilat emetojnë dritë të ndryshme kur ndriçohen me laser. Meqë këto sonda janë të qendrueshme, pra nuk shpërbëhen në brendësi të qelizës, dhe janë jo-helmuese, ato mund të qëndrojnë në bërthamën e qelizës për kohë të gjata.

Kristalet e përdorur në sonda janë pika kuantike apo kristale mikroskopike, të cilat kanë mundësi të depërtojnë nëpër membranën qelizore. Poret e membranave kanë një diametër prej 20 nanometrash, prandaj shkencëtarët përdorën pika kuantike të kadmium-selen-zink-sulfidit të mbështjella me dioksid silici. Pastaj, kërkuesit përdorën proteinën e virusit SV40, për t'a bashkuar me pikën kuantike. Ata shpresojnë që kjo teknologji do të mundësojë që të mësojmë më shumë mbi mënyrat se si vetnëndreqen qelizat, si shkëmbehen mitokondritë dhe shumë procese të tjera jetësore. Sipas shkencëtarëve, pjesa më e vështirë, hyrja në brendësi të bërthamës, është arritur.

Burimi i lajmit: <http://www.lbl.gov/Science-Articles/Archive/LSD-in...>

Përgatiti Genc Kastrati, <http://www.pr-tech.net>

ABETARE E TRAJTIMIT KLINIK TË  
HIPERTENSIONIT  
Minella Aleks  
Protea, Las Vegas, 2005, 132 fq.  
ISBN 1-59344-111-8

Më në fund një libër me vlera është botuar nga shtëpia botuese Protea në Las Vegas. Autori i këtij libri me vlerë është Minella Aleks, mjek me profesion, i cili prej vitesh punon pranë një klinike private në Çikago, IL, USA, si asistenti kryesor.


Libri titullohet *Abetare e trajtimit klinik të hipertensionit*. Siç mund të kuptohet dhe nga titulli, ky libër është një domosdoshmëri për çdo familje shqiptare ta ketë në bibliotekën e saj, jo vetëm për të mësuar për hipertensionin, por edhe për të marrë masat në kohë për të parandaluar komplikacionet për shkak të sëmundjes, përfshi këtu edhe vdekjen.

Librin mund ta gjeni tek faqja elektronike e shtëpisë botuese Protea [www.proteapublishing.com/isbn159344.htm](http://www.proteapublishing.com/isbn159344.htm).

Personalisht e uroj zotin Aleks për këte ndihmesë që i jep komunitetit shqiptar dhe shpresoj që puna e nisur për edukimin dhe ndërgjegjësimin mjekësor të njerëzve të mos përfundojë këtu.

Bashkangjitur është edhe fotografia e kopertinës së librit.

TAN MEZINI



TIVAR 1945 – KALVARI I KOSOVËS,  
Dr. Muhamet Pirraku,  
Prishtinë, 2005, 212 fq.

Në 60-vjetorin e njërit prej krimeve më të rënda në Ballkan, historiani Muhamet Pirraku ka nxjerrë nga shtypi dhe përuroi veprën *Tivari 1945 – kalvari i Kosovës*, një version i përpunuar dhe i zgjeruar të cilin e kish botuar vite më parë. Fjala është për njërin prej temave tabu, për të cilën nuk kishin folur drejtuesit dhe përgjegjësit shtetërorë të këtij krimi, nuk kishin folur e nuk e kishin diskutuar as qarqet politike e shtetërore të shtetit amë, përgjegjësia e të cilëve nuk mund të anashkalohet, nuk kishin ngritur zërin dhe nuk dihet të kenë shkruar as grupet shqiptare të emigracionit dhe natyrisht nuk kishin guxuar për pesë dhjetëvjeçarë me rradhë të shkruajnë e të flasin as historianët. Pushteti politik, ushtarak, policor dhe diplomatik i Beogradit, ku u projektua njëri prej elaborateve më të tmerrshme të krimit në fund të Luftës së Dytë Botërore e mbajti me sukses në kyç këtë temë, pavarësisht se për organizimin, përmbajtjen dhe nivelin e ngjarjes dinin të gjithë: në Prishtinë, në Tiranë, në Beograd dhe në disa qendra të mëdha të politikës ndërkombëtare. Megjithatë dokumentet e pakta për historiografinë tonë kanë qenë mbushur e stërmushur me mbamendjet e shumta të atyre mijëra personave që përjetuan vdekjen e dhunshme të bashkudhëtarëve të tyre në Tivar dhe jo vetëm atje.

Për kontributin që përcjell kjo vepër, në promovim folën historianët dr. Hakif Bajrami, dr. Daut Bislimi, dr. Izber Hoti dhe dr. Shefki Sejdiu.

BEGZAD BALIU

PROTOKOLLI,  
Fadil Maxhuni, Prishtinë, 2005


Libri i autorit Fadil Maxhuni ka qenë një befasi e mirë për dy arsye: e para, për faktin se autori nuk është jurist apo historian. Vetëm interesimi i madh dhe puna në këtë fushë ka bërë që libri të shkruhet nga një punonjës i shkencave teknike. Arsyeja e dytë lidhet me një përvojë modeste që autori ka ditur ta kthejë në art, për t'i dhënë në fund trajtën e një libri si ky që sot lexuesi mban në dorë.

Protokolli është arti i shtetit. Ai nuk është veçse një efekt refleksiv i organizimit politik të një shoqërie. Mbi të gjitha, protokoli përfaqëson nivelin e organizimit politik, natyrën e këtij organizimi, vetë cilësinë e kulturës politike të një shoqërie.

Meqë është libri i parë i këtij lloji, mbesim me shpresë se çdo lëshim eventual i autorit do të jetë nxitje për ne të tjerët, me qëllim të vazhdimit të rrugës së trasuar prej tij.

Libri si i tillë mund të shërbejë, dhe sigurisht do të jetë një mjet i dobishëm për ata që studiojnë çështjet e protokollit, por edhe për të tjerët që duhet të zbatojnë protokollin gjatë punës së tyre. [fadilmaxhuni@yahoo.de](mailto:fadilmaxhuni@yahoo.de)

Prof. ENVER HASANI, PhD  
IZEDIN HAJDINI, ambassador



Në mjediset e Friend's Book House në Tiranë një grup studiuesish përruruan tri vepra për jetën dhe veprimtarinë e Profesor Jup Kastratit: *Profesor Jup Kastrati për Kosovën* (përkujdesja Begzad Baliu dhe Baki Svirca), botoi "Era", Prishtinë, 2004; *Vepra bibliografike e Jup Kastratit*, Begzad Baliu, botoi Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2005, dhe *Mbi autorësinë e bibliografisë së Skënderbeut*, botoi "Era", Prishtinë, 2005.

Takimin e kish organizuar familja Kastrati në bashkëpunim me miq dhe studiues të veprës së Profesor Kastratit. Në hapje të këtij takimi e bija, Fatmira Kastrati, tha se takimi bëhej për dy arsye: përkujtohej një përvjetor i zakonshëm i ditëlindjes së Profesor Kastratit (i ndarë nga jeta dy vjet më parë) dhe përrurohen veprat e dala nga shtypi kohët e fundit.

Në fjalën e tij autori dhe bashkautori i tri prej veprave të botuara Dr. Begzad Baliu, punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe editor i shtëpisë botuese "Era", u ndal kryesisht në punën e bërë për

## U PËRRURUAN TRI VEPRA PËR PROFESOR DR. JUP KASTRATIN Begzad Baliu

botimin dhe studimin e veprës së Profesor Kastratit.

"Veç veprave që po përrurojmë këtu, – tha Baliu – në Prishtinë është organizuar edhe një konferencë shkencore në Institutin Albanologjik, në Fakultetin e Filologjisë është miratuar një tezë doktore me titull "Studimet historiko-letrare të Jup Kastratit", të cilën pritet ta mbrojë ligjeruesja e letërsisë në Fakultetin e Edukimit, Myrvete Dreshaj Baliu, ndërsa një grup studiuesish po punojnë që gjatë vitit 2005 të nxjerrin nga shtypi veprën e plotë të Prof. Jup Kastratit: *Bibliografi albanistike*.

Në vazhdim bashkautori i njëres prej veprave, Baki Svirca, drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, ka folur për mundësinë e parqitjes së dimensioneve të reja të veprës së botuar dhe dorëshkrimeve të Prof. Jup Kastratit, një sprovë e së cilës është bërë me veprën e tij për Kosovën.

Në kujtim të jetës dhe veprës së Profesor Jup Kastratit, si dhe

për veprat e përruara kanë folur studiuesit Prof. Emil Lafe, Prof. Koleç Topalli, shkrimtari Pjetër Arbnori, akademiku Jorgo Bulo, studiuesit Nasho Jorgaqi e Klara Kodra e Neritan Ceka, botuesi Mehmet Gëzhilli, kryetari i shoqatës "Kosova" Dashmir Uruqi e të tjerë. Përgjigje për gjendjen e dorëshkrimeve të Profesor Jup Kastratit dhe të botimit të tyre ka dhënë Diana Kastrati. Të pranishmit kanë vlerësuar në shumë dimensioneve veprën e Profesor Kastratit dhe kanë theksuar rëndësinë e botimit të plotë të veprave në dorëshkrim, duke ju dhënë rëndësi parësore vëllimeve *Historia e albanologjisë* (dy vëllime), *Ndre Mjeda*, *Veprat historikogjuhësore të Jeronim de Radës*, *Bibliografi albanistike*, *Studime arbëreshe* etj. Por, ky projekt, u tha nga të pranishmit, nuk mund të arrihet pa angazhimin e disa institucioneve me përvojë shkencore.

Kohët e fundit ka dalë nga shtypi libri *Filozofia e Teodor Kavaliotit; Voskopoja-Akademia e Re* i prof. Alfred Uçit (Botime i Akademisë së Shkencave).

Në vijim të punës së tij kërkimore-shkencore, pas njëzet librave të botuar mbi estetikën e mitologjinë, antikitetin e modernizmin, folklorin, kulturën e letërsinë, Shekspirin, Dostojevskin, Danten, groteskun kada-rean, De Radën e të tjerë të mëdhenj të letërsisë, kulturës e mendimit shqiptar e më gjërë, prof. Uçi del para lexuesit, sidomos atij të profilizuar, me një tjetër vepër shkencore.

Pse pikërisht për Teodor Kavaliotin dhe filozofinë e tij?

## FILOZOFIA E TEODOR KAVALIOTTI, VEPËR E SHQUAR E MENDIMIT SHQIPTAR Lekë Sokoli

Sepse Kavalioti, sipas Uçit, mbetet një figurë e shquar e kulturës iluministe shqiptare. Vepra e tij përfaqëson në vetvete një trashëgimi të vyer të mendimit filozofik. Por mënyra e shikimit dhe interpretimit prej tij, sidomos të problemeve filozofike, tregon se çfarë kishte arritur Voskopoja e shekullit të XVIII-të. Pra, emri dhe vepra e "fenomenit" Kavalioti lidhen me shkëlqimin e "fenomenit" Voskopoje.

E rëndësishme është që Kavalioti përqafoi filozofinë më për-

parimtare të kohës së tij. Dhe në qoftë se Dekarti ishte në Europë përrpunuesi i një mendimi filozofik modern, përrpunuesi i këtij mendimi në Ballkan ishte shqiptari Kavalioti. Vlerat shtohen po të kemi parasysh faktin se veprat e tij janë "veprat e para laike, sepse gjithë kodikët e tjerë kanë përmbajtje teologjiko-fetare".

Artikullin e plotë me referenca të shumta mund ta gjeni në faqen e Alb-Shkencës [www.alb-net.com/pipermail/alb-shkenca/2005-May/002622.html](http://www.alb-net.com/pipermail/alb-shkenca/2005-May/002622.html)

## STUDIUESI ME I SUKSESSHËM SHQIPTAR PER VITIN 2004

Të nderuar anëtarë të Alb-Shkencës, pas një pune relativisht të gjatë dhe të kujdeshme, arritëm të identifikojmë kandidatët për studiuesin më të suksesshëm shqiptar gjatë vitit 2004 ndërmjet anëtarëve të Alb-Shkencës. Për këtë na erdhi në ndihmë edhe një faqe në internet me të cilën shumë prej jush janë të familjarizuar. Kjo faqe është *ISI Web of Knowledge*, informacioni i së cilës përdoret zakonisht si bazë për kualifikimin e studiuesve të fushave të ndryshme të shkencës.

Në këtë sistem integral, janë të rregjistruar të gjithë botimet e bëra në organe të referuar shkencore në të gjitha gjuhët.

Ne shfrytëzuar këtë burim informacioni për të identifikuar anëtarët më të suksesshëm të Alb-Shkencës, kandidatë për çmimin "Studjuesi më i suksesshëm i vitit 2004". Emrat e tyre i zgjodhëm nga dokumenti i afishuar në faqen tonë në internet në adresën: [www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org), me titull *Botimet shkencore të anëtarëve të Alb-Shkencës për vitin 2004*.

Kriteret që përdorëm në këtë kërkim ishin:

- 1) Botimet shkencore gjatë gjithë karrierës (duhet të jenë 20 ose më shumë);
- 2) Botimet shkencore gjatë vitit 2004 (duhet të jenë 3 ose më shumë);
- 3) Sa herë janë cituar punimet

e tyre shkencore nga studiues të tjerë (duhet të kenë të paktën një artikull të cituar 15 herë ose më shumë).

Nga kërkimi që kryem rezultoi se studjuesit e mëposhtëm i plotësonin të tre kriteret e mësipërme:

### **Dr. Bajram Berisha** (Gjermani)

Dr. Berisha ka gjithsej 49 punime shkencore të referuara; gjatë vitit 2004 ka publikuar 20 punime shkencore; artikulli më i cituar në të cilin Dr. Berisha është autor është cituar 37 herë nga studiues të tjerë të së njejtës fushë.

### **Dr. Dritan Siliqi** (Itali)

Dr. Siliqi ka gjithsej 35 punime shkencore të referuara; gjatë vitit 2004 ka publikuar 6 punime shkencore; dhe njeri nga arikujt ku Dr. Siliqi është autor është cituar 15 herë nga studiues të tjerë të së njejtës fushë.

### **Dr. Arben Merkoçi** (Spanjë)

Dr. Merkoçi ka gjithsej 36 punime shkencore të referuara; gjatë vitit 2004 ka publikuar 6 punime shkencore dhe njeri nga arikujt ku Dr. Merkoçi është autor është cituar 55 herë nga studiues të tjerë të së njejtës fushë.

### **Dr. Sokrat Sinaj** (Zvicër)

Dr. Sinaj ka gjithsej 28 punime shkencore të botuara në organe

shkencore të referuar; gjatë vitit 2004 ka publikuar 3 punime shkencore. Njeri prej artikujve në të cilin Dr. Sinaj është autor, është cituar 34 herë nga studiues të tjerë të së njejtës fushë.

### **Dr. Robert Magari** (USA)

Dr. Magari ka gjithsej 23 punime shkencore të referuara; gjatë vitit 2004 ka publikuar 3 punime shkencore dhe njeri nga arikujt ku Dr. Magari është autor është cituar 15 herë nga studiues të tjerë të së njejtës fushë.

Duke filluar nga 1 maji, do të kryhet një sondazh në faqen e Alb-Shkencës për të zgjedhur me votim **STUDJUESIN ME TE SUKSESSHËM TE VITIT 2004**.

Megjithëse ne u munduam që kërkimin tonë ta bënim sa më të ndershëm dhe e kryem për pothuaj të gjithë anëtarët e Alb-Shkencës të cilët janë përfshirë në listën e botimeve të 2004, nuk patëm mundësi që ta bënim për të gjithë 450 anëtarët e rregjistruar deri tani tek Alb-Shkenca.

Gjithashtu, nuk përjashtojmë mundësinë edhe të ndonjë gabimi eventual. Për këtë do t'ju luteshim që nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme, dërgoni një mesazh në adresën: [moderatori@alb-shkenca.org](mailto:moderatori@alb-shkenca.org)

Menjëherë pas verifikimit, ne do t'ju përfshijmë në listën e kandidatëve për studiuesin më të suksesshëm të vitit 2004.

Ju urojmë të gjithëve punë dhe studime të mbara.

Në faqen tone në internet në adresën: [www.alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org) kemi afishuar projektin e parë të statutit të Alb-Shkencës të përpiluar nga grupi i punës që është ngritur për të diskutuar dhe vendosur për të ardhmen e Alb-Shkencës në kuadër të hipotezës së organizimit të saj fizik si shoqatë, organizatë apo institut. Këte projekt-statut mund ta gjeni në rubrikën "Artikujt e fundit" në të djathtë të ekranit. Meqenëse grupi i punës po e diskuton aktualisht në detaje këtë projekt, do t'ju luteshim të gjithëve që ta lexoni me vëmendje atë dhe të dërgoni komentet tuaja në listën e forumit tonë apo në adresën: [moderatori@alb-shkenca.org](mailto:moderatori@alb-shkenca.org)

Në qoftë se do të keni dëshirë të kontribuoni në grupin e punës, ju mund të bëheni anëtarë të tij në çdo kohë, duke dërguar një mesazh në adresën: [moderatori@alb-shkenca.org](mailto:moderatori@alb-shkenca.org)

**M**e kënaqësi vërejmë se numri i anëtarëve të forumit tonë po rritet pothuajse çdo ditë dhe po i afrohet shifrës 500 ndërsa numri i vizitave e ka kaluar shifrën 6230. Auditori virtual i Alb-Shkencës ka tani një shtrirje që mbulon mbi 30 vende të ndryshme të botës dhe përbëhet nga studiues, pedagogë, studentë universitarë dhe pasuniversitarë, si dhe dashamirës të shkencës. Formimi profesional i anëtarëve të Alb-Shkencës është jashtëzakonisht i larmishëm dhe i ka dhënë asaj cilësitë e një institucioni unikal të shqiptarëve të Ballkanit dhe diasporës. Në mënyrë që ta bëjmë edhe më të larmishëm forumin tonë, do t'iu luteshim edhe një herë që të vazhdoni "ta reklamoni" Alb-Shkencën tek të gjithë të njohurit tuaj të cilët mund të kontribuojnë apo përfitojnë duke u bërë anëtarë të saj.

Së fundi në faqen tonë instalam një sistem të ri të profileve që është më funksional se i mëparshmi. Me ndihmën tuaj kjo faqe do të pasurohet edhe më shumë në të ardhmen.

Të gjithë duhet të pasurojmë "Bibliografinë" duke shtuar aty referencat e plota të të gjitha botimeve të referuara të kryera gjatë gjithë karrierës.

Gjithashtu duhet të vazhdojmë të pasurojmë "Fjalorthët e termave shkencore"; fjalorthi i shkencave të bujqësisë dhe mjedisit ka aktualisht mbi 150 terma dhe 5 autorë. Ne kemi ndërmend ta botojmë këtë fjalorth pas të ketë marrë një formë më të plotë. Ju ftojme edhe një herë të gjithëve që të shtoni termat tuaja në fjalorthët e faqes sonë. Sistemi i instaluar në këtë faqe është shumë i lehtë për tu përdorur si për të shtuar terma ashtu edhe për të shtuar burimet bibliografike të punimeve tuaja.

Gjithashtu në këtë faqe ndodhet edhe lidhja e "Seksioneve" të Alb-Shkencës, të cilat mund të shërbejnë si forume të studiuesve të së njëjtës degë. Atje mund të diskutohen probleme shkencore specifike të fushave përkatëse të studimit, si dhe mund tu drejtohen pyetje specialistëve të këtyre fushave.

Edhe interesi për Buletin tonë mujor është gjithashtu në rritje dhe anëtarë të ndryshëm të Alb-Shkencës kanë filluar të na dërgojnë shkrimet e tyre për ti botuar në këtë buletin. Do t'ju luteshim dhe inkurajonim të gjithëve që të vazhdoni të na dërgoni shkrimet e përkthimet tuaja. Gjithashtu ne po zgjerojmë edhe këshillin botues të Alb-

Shkencës me anëtarë të rinj. Na shkruani menjëherë në adresat [buletini@alb-shkenca.org](mailto:buletini@alb-shkenca.org) ose [moderatori@alb-shkenca.org](mailto:moderatori@alb-shkenca.org) nëse keni dëshirë të bëheni anëtarë të këtij këshilli. Detyrat e këtyre anëtarëve janë: botimi i shkrime divulgativo-shkencore në fushën e tyre të studimit, të përkthejnë apo të jenë redaktorë teknikë, letrarë e gjuhësorë.

Lista në internet e forumit tonë ([alb-shkenca@alb-net.com](mailto:alb-shkenca@alb-net.com)) do të vazhdojë të funksionojë si pikë takimi e të gjithë anëtarëve të Alb-Shkencës ku do të shkëmbehen mendime rreth temave të përgjithshme me karakter shkencor si dhe çështjeve më thelbësore me të cilat ballafaqohen sot shqiptarët. Të gjithë së bashku të përpiqemi që ta rrisim cilësinë e shkrimeve që dërgohen në Alb-Shkencë dhe të përpiqemi t'i përmbahemi në maksimum etikës së këtij forumi. Aktualisht vetëm 25 % e shkrimeve që dërgohen në forum shpërndahen në listë. Do t'ju luteshim gjithashtu që shkrimet që dërgoni t'i nënshkruani me emër të plotë, si dhe të evitoni plotësisht dërgimin e shkrimeve nga adresa elektronike që nuk lejojnë identifikimin e personit që shkruan mesazhin.

## Në rritje diabeti i tipit 2 midis adoleshentëve

Këto 15 vitet e fundit përhapja e diabetit të tipit 2 ndër adoleshentët ka marrë përmasa të mëdha. Kjo, me sa duket, varet shumë nga rritja e obezitetit pediatrik.

Kjo ndërlidhje doli në pah në një artikull të publikuar tek revista *The Journal of Pediatrics* nga një grup studiuesish të drejtuar nga izraeliani Orit Pinhas-Hamiel i Sheba Medical Center dhe amerikani Philip Zleiter i Universitetit të Kolorados.

Shkencëtarët morën në shqyrtim të gjitha studimet e kryera për këtë temë nga viti 1978 deri në vitin 2004 dhe zbuluan se 45 përqind e rasteve të reja të diabetit të rregjistruar tek adoleshentët i takojnë tipit 2 d.m.th. atij që nuk ka origjinë gjenetike por që shkaktohet nga stili i gabuar i jetesës.

Në disa grupe etnike, kjo përqindje është më e lartë: arrin deri në 80 përqind në Japoni dhe 70 përqind midis indianëve të Amerikës. Këta të fundit janë edhe populli me përqindje më të lartë diabeti të tipit 2 edhe tek moshat e rritura.

Sipas autorëve të shkrimit, ky studim tregon se obeziteti po bëhet me shpejtësi njeri nga problemet sanitare me impakt më të lartë në botë.

*Journal of Pediatrics*

**M**ë poshtë është një përmbledhje e një studimi të kryer nga 1300 specialistë nga 95 shtete të ndryshme rreth ndryshimeve në ekosistemet natyrore. Studiuesit janë të mendimit që degradimi i këtyre sistemeve do të vazhdojë me ritme të shpejtë në 50 vjetët e ardhshëm. Për një sintezë të katër problemeve kryesore të identifikuar në këtë studim, lexoni më poshte.

EXPERTS WARN ECOSYSTEM CHANGES WILL CONTINUE TO WORSEN, PUTTING GLOBAL DEVELOPMENT GOALS AT RISK

A landmark study released today reveals that approximately 60 percent of the ecosystem services that support life on Earth – such as fresh water, capture fisheries, air and water regulation, and the regulation of regional climate, natural hazards and pests – are being degraded or used unsustainably. Scientists warn that the harmful consequences of this degradation could grow significantly worse in the next 50 years.

“Any progress achieved in addressing the goals of poverty and hunger eradication, improved health, and environmental protection is unlikely to be sustained if most of the ecosystem services on which humanity relies continue to be degraded,” said the study, Millennium Ecosystem Assessment (MA) Synthesis Report, conducted by 1,300 experts from 95 countries. It specifically states that the ongoing degradation of ecosystem services is a road block to the Millennium Development Goals agreed to by the world leaders at the United Nations in 2000.

Although evidence remains incomplete, there is enough for the experts to warn that the ongoing degradation of 15 of the 24 ecosystem services examined

is increasing the likelihood of potentially abrupt changes that will seriously affect human well-being. This includes the emergence of new diseases, sudden changes in water quality, creation of “dead zones” along the coasts, the collapse of fisheries, and shifts in regional climate.

The MA Synthesis Report highlights four main findings:

**a.** Humans have changed ecosystems more rapidly and extensively in the last 50 years than in any other period. This was done largely to meet rapidly growing demands for food, fresh water, timber, fiber and fuel. More land was converted to agriculture since 1945 than in the 18th and 19th centuries combined. More than half of all the synthetic nitrogen fertilizers, first made in 1913, ever used on the planet has been used since 1985. Experts say that this resulted in a substantial and largely irreversible loss in diversity of life on Earth, with some 10-30% of the mammal, bird and amphibian species currently threatened with extinction.

**b.** Ecosystem changes that have contributed substantial net gains in human well-being and economic development have been achieved at growing costs in the form of degradation of other services. Only four ecosystem services have been enhanced in the last 50 years: increases in crop, livestock and aquaculture production, and increased carbon sequestration for global climate regulation. Two services – capture fisheries and fresh water – are now well beyond levels that can sustain current, much less future, demands. Experts say that these problems will substantially diminish the benefits for future generations.

**c.** The degradation of ecosystem services could grow signi-

ficantly worse during the first half of this century and is a barrier to achieving the UN Millennium Development Goals. In all the four plausible futures explored by the scientists, they project progress in eliminating hunger, but at far slower rates than needed to halve number of people suffering from hunger by 2015. Experts warn that changes in ecosystems such as deforestation influence the abundance of human pathogens such as malaria and cholera, as well as the risk of emergence of new diseases.

Malaria, for example, accounts for 11 percent of the disease burden in Africa and had it been eliminated 35 years ago, the continent’s gross domestic product would have increased by \$100 billion.

**d.** The challenge of reversing the degradation of ecosystems while meeting increasing demands can be met under some scenarios involving significant policy and institutional changes. However, these changes will be large and are not currently under way. The report mentions options that exist to conserve or enhance ecosystem services that reduce negative trade-offs or that will positively impact other services. Protection of natural forests, for example, not only conserves wildlife but also supplies fresh water and reduces carbon emissions.

“The over-riding conclusion of this assessment is that it lies within the power of human societies to ease the strains we are putting on the nature services of the planet, while continuing to use them to bring better living standards to all,” said the MA board of directors in a statement. “Living beyond Our Means: Natural Assets and Human Well-being.”



"Achieving this, however, will require radical changes in the way nature is treated at every level of decision-making and new ways of cooperation between government, business and civil society. The warning signs are there for all of us to see. The future now lies in our hands."

The MA Synthesis Report also reveals that it is the world's poorest people who suffer most from ecosystem changes. The regions facing significant problems of ecosystem degradation – sub-Saharan Africa, Central Asia, some regions in Latin America, and parts of South and Southeast Asia – are also facing the greatest challenges in achieving the United Nations' Millennium Development Goals. In Sub-Saharan Africa, for example, the number of poor people is forecast to rise from 315 million in 1999 to 404 million by 2015.

"Only by understanding the environment and how it works, can we make the necessary decisions to protect it. Only by valuing all our precious natural and human resources can we hope to build a sustainable future," said Kofi Annan, secretary

general of the United Nations in a message launching the MA reports. "The Millennium Ecosystem Assessment is an unprecedented contribution to our global mission for development, sustainability and peace."

The Millennium Ecosystem Assessment (MA) Synthesis Report is the first in a series of seven synthesis and summary reports and four technical volumes that assess the state of global ecosystems and their impact on human well-being. This report is being released together with a statement by the MA board of directors entitled "Living beyond Our Means: Natural Assets and Human Well-being."

The MA Secretariat is coordinated by the United Nations Environment Programme (UNEP).

The MA is recognized by governments as a mechanism to meet part of the assessment needs of four international environmental treaties – the UN Convention on Biological Diversity, the Ramsar Convention on Wetlands, the UN Convention to Combat Desertification, and the Convention on Migratory Species. It is supported by 22 of the

world's leading scientific bodies, including The Royal Society of the U.K. and the Third World Academy of Sciences.

The MA's work is overseen by a 45-member board of directors, co-chaired by Dr. Robert Watson, chief scientist of The World Bank, and Dr. A. H. Zakri, director of the United Nations University's Institute of Advanced Studies. The Assessment Panel, which oversees the technical work of the MA, includes 13 of the world's leading social and natural scientists. It is co-chaired by Angela Cropper of the Cropper Foundation, and Dr. Harold Mooney of Stanford University. Dr. Walter Reid is the director of the Millennium Ecosystem Assessment.

#### NDREQJE GABIMESH

Në buletin e kaluar, në shkrimin "Një libër i ri mbi emigracionin shqiptar" sjellë nga Juli Vullnetari pasaktësisht kemi thënë se autorët e librit janë Russell e Stefani por në të vërtetë në vëllim ka edhe emra të tjerë që kanë kontribuar në të. Russell e Stefani janë edituesit e librit. Ju kërkohet ndjesë lexuesve dhe autores së shkrimit.

### Lokalizohet në kromozomin 17 zona e gjenit të autizmit

Kërkimi i gjeneve që lidhen me autizmin hyn në një fazë të re. Për herë të parë një grup shkencëtarësh në UCLA (University California of Los Angeles) arriti që të izolojë një zonë të kromozomit 17 në brendësi të së cilës gjendet gjeni që lidhet me këtë sëmundje.

Në një artikull të publikuar tek revista *American Journal of Human Genetics* kërkuesit të kryesuar nga Dan Geschwind shpjegojnë se hapi i mëvonshëm do të jetë identifikimi i saktë i pozicionit të gjenit në mënyrë që të studjohen mutacionet e tij që lidhen me zhvillimin e autizmit.

Studime të mëparshme kanë treguar se ky gjen është aktiv vetëm tek meshkujt, gjë e cila mund të shpjegojë motivin se përse kjo sëmundje prek më tepër djemtë se sa vajzat.

Grupi i shkencëtarëve me dy studime të veçanta arriti të lokalizojë gjenin përgjegjës të autizmit në zonën e quajtur 17Q21. "Është hapi i parë për të patur një kuadër më të plotë e të besueshëm të sëmundjes dhe për të realizuar terapi më efikase" shkruajnë studiuesit.

University California of Los Angeles

Për të interesuarit në kërkim për shkolla verore:

[www.summeracademy.etc-graz.at/](http://www.summeracademy.etc-graz.at/)

#### BACKGROUND

The lack of opportunity to study the relationship between Human Rights, Human Development and Human Security has inspired the idea of the ETC International Summer Academy which in 2003 turned out to be a very successful and sustainable event. The ETC established the Summer Academy in the Human Rights City of Graz as a way to enhance the realization of the Human Security agenda. Awareness of the concept of Human Security, shared understanding of its interdisciplinary and cross cutting character and its potential for international policy and decision-making is a pre-condition for the effective promotion of Human Security locally and globally. The ETC's latest contribution to this promotion is a direct offspring of the 2003

Summer Academy and the enthusiasm of its participants: the scientific online journal *Human Security Perspectives* launched in February 2004.

#### OBJECTIVES

- To create a better understanding of the relevance of the concept of human security
- To present and discuss indicators defining the state of Human Security
- To explore the linkages between Human Rights, Human Development and Human Security
- To discuss the agenda of the HSN states to improve Human Security
- To promote Human Security, Human Rights and Human Development in a holistic way
- To raise awareness about Human Rights Education as a tool for Human Security
- To provide the basis for capacity-building in Human Security Network states and beyond and networking on governmental, NGO and academic levels on Hu-

man Rights and Human Security.

#### METHODOLOGY

The Summer Academy draws on the expertise of a selected group of academics, practitioners and decision-makers from various sectors, which guarantees a broad approach to the questions of Human Security worldwide. To assure sustainability and multiplicatory effects the training methods put particular emphasis on the interactive approach. The Academy is designed as a modular course and allows for the transfer of knowledge as well as the acquisition of skills and the shaping of attitudes.

#### TARGET GROUP

The Summer Academy is designated for postgraduate students and re-searchers, young collaborators of ministries and of NGOs from all over the world with a focus on South Eastern Europe and HSN members with a focus on South Eastern Europe and developing countries.

### Fëmijët mësojnë të flasin edhe para se të mbushin vitin e parë

Bëni kujdes për ato që thoni: edhe fëmijët një vjeçarë mund të kuptojnë fjalët tuaja. Kështu thotë Graham Schafer, psikolog në Universitetin anglez në Reading. Sipas këtij studiuesi, aftësia për të mësuar domethënien e fjalëve zotërohet qysh para mbushjes së vitit të parë të jetës i cili deri tani ish mbajtur si momenti kyç i mësimit të gjuhës.

"Eksperimenti ynë – shpjegon Schafer – tregon se fëmijët e vegjël mund të kuptojnë përdorimin e fjalëve në një mënyrë më elastike sesa ajo që pedagogë e prindër mendonin deri tani". Psikologu kontaktoi prindërit e 52 fëmijëve nëntë muajsh dhe u kërkoi atyre që tu tregonin foshnjeve 12 libra për fëmijë dhe 48 fotografi objektsh të përdorimit të përditshëm si çelësi, molla, peshku, tryeza etj. Fëmijët duhet ti shihnin këto imazhe katër herë në javë për 10 minuta si një farë loje rutinë me shumë variante: trego fotografinë, gjej fotografinë e fshehur, shqipto emrin e saj... Pas tre muajsh, fëmijët (që tashmë kishin mbushur vitin) duhet të kryenin një test: zgjidheshin dy foto të ngjashme (jo të njejta) me ato me të cilat ata kishin luajtur kohë më parë dhe ju kërkoheshin që të shihnin njerën. "Shiko, shiko peshkun!" dhe vlerësohej kështu nëse vogëlushi ishte i aftë të kuptonte e të njihnte objektin. U pa se fëmijët që ishin ushtruar me prindërit tre muaj më parë shihnin me të vërtetë fotografinë e kërkuar ndërsa fëmijët e tjerë nuk bënë këtë gjë.

"Eshtë një rezultat i kënaqshëm sepse gjatë testit fëmijët kishin të bënë me fotografi të reja dhe më zëra të rinj jashtë kuadrit familjar" vazhdon Schafer, "prandaj mund të nxjerrim përfundimin se fëmijët me të vërtetë kanë mësuar domethënien e fjalëve". E kjo tregon se nuk ka një moment preçiz për të filluar që tju flasin fëmijëve të sapolindur"

*Child Development*